

VENDIM
Nr.621, datë 8.7.2010

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.717, DATË 23.6.2009 “PËR
PAGAT E PUNONJËSVE MBËSHTETËS TË INSTITUCIONEVE BUXHETORE DHE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE BUXHETORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.717, datë 23.6.2009, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Lidhja I “Nivelet e pagës bazë për klasë në administratën e Presidentit, Kuvendit, në Kryeministri, institucione të pavarura, aparatet e ministrave të linjës, institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, e përmendur në pikën 1, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Lidhja nr.2 “Nivelet e pagës bazë për klasë në institucionet rajonale dhe vendore”, e përmendur në pikën 2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

c) Në lidhjen I/1 “Renditja e pozicioneve të përgjithshme të punës, për çdo klasë për punonjësit mbështetës në administratën e ministrave të linjës, institucioneve të pavarura e kushtetuese, institucioneve qendrore, në varësi të Kryeministrit/ministrave të linjës dhe në prefektura”, të shtohet emërtesa “Anketues në INSTAT, klasa V”.

ç) në lidhjen I/8 “Renditja e pozicioneve të veçanta të punës për çdo klasë për punonjësit mbështetës në institucionet qendrore në varësi të Ministrit të Mbrojtjes të grupit të parë e të dytë”, shtohen emërtimet e mëposhtme:

“Ofsetist në Institutin Gjeografik të Ushtrisë, klasa VIII”;

“Shofer automjeti transporti mbi 2.5 ton, klasa V. “.

d) Paragrafi i dytë i pikës 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Këto shtesa, për të katër shkallët, llogariten mbi pagën bazë të klasës VI, të lidhjeve përkatëse.”.

dh) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11.a Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “A”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006 “Për pagat, shpërblimet dhe strukturat e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, të cilët, në bazë të lidhjes nr.1 të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë”, kanë në dispozicion shoferë që nuk janë punonjës të Gardës së Republikës, përfitojnë pagën sipas klasës VII të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse në masën 13 500 (trembëdhjetë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

b) Shoferët e titullarëve të klasifikuar në grupin “B” dhe në grupin “C”, për efekt të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, të cilët në bazë të lidhjes nr.1 të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë”, kanë në dispozicion shofer, përfitojnë pagën sipas klasës VI të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse në masën 9500 (nëntë mijë e pesëqind) lekë në muaj.

c) Shoferët e titullarëve të tjerë, të cilët në bazë të lidhjes nr.1 të ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët politikë dhe nëpunësit civilë”, kanë në dispozicion shoferë, përfitojnë pagën sipas klasës V të lidhjes nr.I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe një shtesë mbi pagën mujore të klasës përkatëse në masën 6500 (gjashtë mijë e pesëqind) lekë në muaj.”.

e) Pika 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“16. Punonjësit në pozicionin “Shofer - mekanik” në Qendrën e Shërbimeve dhe

Administrimit të Mjeteve të Transportit, në Ministrinë e Brendshme, përfitojnë një shtesë mbi pagë, në masën 5000 (pesë mijë) lekë në muaj.”.

2. Efektet financiare për vitin 2010, për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, do të përballohen nga fondet e parashikuara në Buxhetin e Shtetit për rritjen e pagave, për vitin 2010.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 korrik 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Lidhja nr. I

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT,
NË KRYEMINISTRI, INSTITUCIONE TË PAVARURA, APARATET E MINISTRIVE TË
LINJËS, INSTITUCIONE QENDRORE NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT/MINISTRAVE TË
LINJËS DHE NË PREFEKTURA

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
I	I	19 000
2	II	20 700
3	III	21 700
4	IV	22 300
5	V	23 500
6	VI	25 500
7	VII	27 500
8	VIII	30 500
9	IX	34 000
10	X	36 500

Lidhja nr. II

NIVELET E PAGËS BAZË PËR KLASË NË INSTITUCIONET RAJONALE DHE VENDORE

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1	I	19 000
2	II	20 700
3	III	21 700
4	IV	22 300
5	V	23 500
6	VI	24 500
7	VII	25 000
8	VIII	25 600
9	IX	27 200
10	X	28 500
11	XI	29 500
12	XII	31 500
13	XIII	33 000
14	XIV	35 000